



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në mbështetje të nenit 12, pikat 12.1 dhe 12.2, shkronja **c** dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja **a** të Ligjit 03/I-040, për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/04, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **c** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2019, miratoi këtë:

## **RREGULLORE MBI THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE TË FËMIJËVE**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi i Rregullores**

Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen procedurat për themelimin, strukturimin dhe funksionimin e Asamblesë Komonale të Fëmijëve në Komunën e Prishtinës, në të cilën parashihet që të delegohen përfaqësuesit e zgjedhur nga të gjitha shkollat e mesme të ulëta, më tutje SHMU.

#### **Neni 2**

#### **Qëllimet e Asamblesë**

- 2.1. Pjesëmarrja aktive në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin;
- 2.2. Zhvillimi i bashkëpunimit me këshillat drejtues të shkollave, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal;
- 2.3. Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me mekanizmat dhe organizatat tjera;
- 2.4. Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve;
- 2.5. Avokimi mbi çështje të ngritura nga vetë fëmijët;
- 2.6. Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete të identifikuar nga vetë fëmijët, dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve;

- 2.7. Inkurajimi i tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimi;
- 2.8. Promovimi i vlerave shoqërore;
- 2.9. Nxitja e ndjenjës për t'u marrë në të ardhmen me aktivitete institucionale dhe politike.

### **Neni 3**

#### **Kompetencat**

Obligimet dhe detyrat e Asamblesë:

- 3.1. Të bëjë parashtrimin e kërkesave, mendimeve dhe sugjerimeve për institucionet relevante komunale, për këshillat e shkollave, këshillat e prindërve dhe drejtoritë lidhur me zbatimin e rregulloreve të sjelljes në shkollë, planin e zhvillimit të shkollës, aktivitetet e lira, pjesëmarrjen në organizime sportive dhe konkurse të tjera, si dhe organizimin e të gjitha manifestimeve të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj në interes të fëmijëve;
- 3.2. Të sigurojë bashkëpunimin e nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
- 3.3. Të bëjë informimin e nxënësve rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për arsimimin e tyre, përmes komunikimit të rregullt me këshillat e shkollave;
- 3.4. Të bëjë hartimin e planit vjetor të punës.

### **Neni 4**

#### **Organizimi i Asamblesë**

Organizimi i Asamblesë në Komunën e Prishtinës do të jetë , si në vazhdim:

- 4.1. Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete e ndihmon, monitoron dhe raporton për punën e Asamblesë;
- 4.2. Organet e Asamblesë janë: kryetar-ja/i, kryesia, e përbërë nga 5 anëtarë, dhe komisione të organizuara të përzgjedhura nga vetë asamblastët;
- 4.3. Koordinatorin për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore nga Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete, organizon zgjedhjet për Asamble, në koordinim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës;
- 4.4. Përfaqësimi i nxënësve në Asamble bëhet me përfaqësues nga secila shkollë, proporcionalisht me numrin e nxënësve në shkollë;
- 4.5. Përfaqësuesit e deleguar në Asamble zgjidhen në SHMU, përmes procesit zgjedhor, në fillim të vitit shkollor, ku përfshihen nxënësit e klasave gjashtë-tetë (6-8);
- 4.6. Numri i fëmijëve në Asamble duhet të jetë i njëjtë me numrin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

### **Neni 5**

#### **Vendimet e Asamblesë**

Asambleja merr vendime për arritjen e qëllimeve të përcaktuara:

- 5.1. Miraton planin vjetor të punës së Asamblesë;
- 5.2. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Asamblesë;

- 5.3. Zgjedh dhe shkarkon komisionet;
- 5.4. Shqyrton dhe miraton së paku një raport vjetor të punës së kryesisë dhe komisioneve;
- 5.5. Shqyrton dhe miraton propozimet e anëtarëve të Asamblesë dhe komisioneve.

#### **Neni 6**

##### **Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të Asamblesë**

- 6.1. Në takim të përbashkët, Këshilli i nxënësve fton kryesitë e klasave 6-8;
- 6.2. Nga të gjithë nxënësit e ftuar në takim përzgjidhen përfaqësuesit për Asamble, në mënyrë të fshehtë, sipas nenit 4, par.4.4, të kësaj rregulloreje;
- 6.3. Secili nxënës i pranishëm në takim ka të drejtë të propozojë dhe të jetë i propozuar;
- 6.4. Secili nxënës ka të drejtë të deklarohet se a pajtohet të jetë kandidat përfaqësues i shkollës për Asamble;
- 6.5. Nxënësit e kandiduar për përfaqësues të Asamblesë paraqiten me një fjalë rasti;
- 6.6. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes procesit të votimit, të hapur ose të mbyllur;
- 6.7. Përzgjedhja e asamblistëve bëhet në javën e tretë të tetorit, në çdo dy vjet;
- 6.8. Duke respektuar kuotën gjinore dhe gjithëpërfshirjen, përzgjidhen kandidatët të cilët kanë numrin më të madh të votave (varësisht nga numri i asamblistëve që do të përzgjidhen);
- 6.9. Nëse ka numër të barabartë të votave, atëherë shkohet në rundin tjetër. Komisioni zgjedhor është gjithëpërfshirës.

#### **Neni 7**

##### **Mbledhjet e Asamblesë**

- 7.1. Gjatë një viti kalendarik janë obliguese katër mbledhje të Asamblesë, por nëse është e nevojshme mund të ketë edhe më shumë mbledhje, me propozim të kryetarit, kryesisë, dhe sipas iniciativës së një të tretës (1/3) së anëtarëve të Asamblesë;
- 7.2. Asambleja vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm;
- 7.3. Anëtarët informohen përmes postës elektronike dhe formave të tjera, për pikat e rendit të ditës, kushtet e seancës dhe informata shtesë;
- 7.4. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjeve është gjysma (1/2) plus një (shumica e thjeshtë).

#### **Neni 8**

##### **Përgjegjësitë e anëtarëve të Asamblesë**

- 8.1. Anëtarët e Asamblesë kanë mandat dyvjeçar dhe mund të rizgjidhen në të njëjtin funksion.
- 8.2. Mandati i anëtarëve të Asamblesë përfundon me dorëheqje, pas përfundimit të mandatit, ose në bazë të mungesës pa arsye në tri seanca radhazi;
- 8.3. Asambleja raporton me shkrim te Sektori për të drejta të njeriut dhe komunitete.
- 8.4. Secili anëtar i Asamblesë njofton Këshillin e nxënësve në shkollën e vet për punën e Asamblesë.



## **Neni 9**

### **Të drejtat e anëtarëve të Asamblesë**

Anëtarët e Asamblesë kanë të drejtë:

- 9.1. të marrë pjesë në arritjen e objektivave të Asamblesë;
- 9.2. të marrë pjesë në punën e Asamblesë, në kushte të barabarta me anëtarët e tjerë;
- 9.3. të propozojë projektet, veprimet dhe dokumentet e tjera të Asamblesë për vendimmarrje;
- 9.4. të marrë pjesë në realizimin e të gjitha aktiviteteve të Asamblesë;
- 9.5. të informohet në kohën e duhur për punën dhe aktivitetet e Asamblesë;
- 9.6. të shprehet lirshëm;
- 9.7. të kërkojë dhe të marrë informata nga kryesia për çështje të rëndësishme në lidhje me ushtrimin e funksionit të asamblistit të ri;
- 9.8. të ketë vetëm një propozim për një çështje të caktuar;
- 9.9. të shfrytëzojnë ambientet e Asamblesë që u janë dhënë në dispozicion për punë dhe takime, në bashkëpunim me Komunën/Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

## **Neni 10**

### **Detyrat e anëtarëve të Asamblesë**

Anëtarët e Asamblesë janë të obliguar:

- 10.1. të kontribuojë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave;
- 10.2. të marrin pjesë në aktivitetet e Asamblesë, në përputhje me interesat e zgjedhësve;
- 10.3. ta respektojnë njëri-tjetrin;
- 10.4. të kryejnë detyra të tjera që u janë besuar atij/asaj nga Asambleja;
- 10.5. t'i përgjigjen ftesës së kryetarit të Asamblesë lidhur me punë e Asamblesë;
- 10.6. të nënshkruhen në fillim dhe mbarim të seancës për praninë e tyre;
- 10.7. ta aprovojnë, ndryshojnë apo plotësojnë rendin e ditës të propozuar nga kryetari, me shumicë votash;
- 10.8. të votojnë, me shumicë votash, propozimin e arsyetuar për shtyrjen apo tërheqjen e pikave të caktuara të rendit të ditës.

## **Neni 11**

### **Mënyra e votimit**

- 11.1. Votimi mund të bëhet me vota të hapura ose të mbyllura. Për këtë vendosin asamblistët.
  - a) Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës,
  - b) Votimi i mbyllur (i fshehtë) bëhet me fletëvotime. Votimin e fshehtë e udhëheq dhe monitoron komisioni i votimit;
- 11.2. Para se të fillohet me votim të fshehtë, Asambleja propozon dhe zgjedh tre (3) anëtarë të komisionit për numërimin e votave dhe për gjetjen e parregullsive në votim;

- 11.3. Konsiderohet i pavlefshëm fletëvotimi, prej të cilit nuk mund të konstatohet me saktësi se si ka votuar asamblisti;
- 11.4. Pjesëmarrësit në votim kanë të drejtë të votojnë vetëm një (1) herë;
- 11.5. Seancat janë të hapura dhe publike.

## **Neni 12**

### **Zgjedhja e kryetarit/es dhe Kryesisë së Asamblesë**

- 12.1. Asambleja zgjedh një (1) kryetar, dy (2) nënkryetarë, një (1) sekretar dhe një (1) arkëtar;
- 12.2. Të dy nënkryetarët propozohen dhe zgjidhen nga anëtarët e Asamblesë, duke votuar;
- 12.3. Sekretari dhe arkëtari propozohet nga kryetari i Asamblesë dhe votohen nga Asambleja;
- 12.4. Zgjedhja e kryetarit/es bëhet me vota të hapura ose të mbyllura;
- 12.5. Kryetari/ja i/e porsazgjedhur pas fjalimit të tij/saj rreth objektivave përgjatë punës, menjëherë hap votimin për përzgjedhjen e Kryesisë (nënkryetarëve, sekretarit/es, arkëtarit/es).

## **Neni 13**

### **Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e kryetar-it/es të Asamblesë**

- 13.1. Kryetar-i/ja ka mandat të plotë 2-vjeçar nga momenti i zgjedhjes së tij/saj;
- 13.2. Kryetar-i/ja mund të bëjë propozime dhe ka të drejtë vote. Në rast të votimit të barabartë, vota e kryetar-it/ës është një votë më shumë;
- 13.3. Ka të drejtë të ndërpresë seancën, nëse ka parregullsi;
- 13.4. Ka të drejtë ta largojë asamblist-in/en nga salla, nëse ka shkelur Kodin e mirësjelljes;<sup>1</sup>
- 13.5. Kujdeset për zbatimin e Rregullores së punës dhe për përmirësimin e kushteve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve;
- 13.6. Kryetari/ja duhet ta thërret mbledhjen së paku katër herë në vit, por sipas nevojës edhe më shumë;
- 13.7. Kryetar-i/ja nuk duhet të mungojë në tri (3) mbledhje radhazi, po që se ai/ajo mungon pa arsye, atëherë mund të kërkohet shkarkimi i tij/saj;
- 13.8. Kryetar-i/ja nuk guxon të bëjë anime (ndarje);
- 13.9. Nëse kryetar-i/ja mungon, vazhdon seanca me nënkryetarin/en i/e parë;
- 13.10. Nëse mungon edhe nënkryetari/ja i/e parë, atëherë vazhdon me të dytin. Nëse kryetari/ja bën shkelje të Rregullores së punës dhe Kodit të mirësjelljes, ai/ajo mund të shkarkohet me votimin e 2/3 të asamblistëve;
- 13.11. Kryetar-i/ja të ketë selinë pranë Sektorit për të drejtat e njeriut.

---

<sup>1</sup> Dokument shtesë i krijuar nga Asambleistët

#### **Neni 14**

##### **Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetarëve**

- 14.1. Asambleja duhet të ketë 2 nënkryetarë;
- 14.2. Nënkryetari i dytë duhet të përzgjidhet nga komunitetet jo shumicë;
- 14.3. Nënkryetar-i/ja i Asamblesë i ndihmon kryetarit/es në kryerjen e punëve dhe kryen punë të tjera nga fushëveprimet e tij/saj;
- 14.4. Me autorizimin e kryetarit, mund ta zëvendësojë atë brenda dhe jashtë vendit, varësisht nga agjenda e takimit.

#### **Neni 15**

##### **Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit/es**

- 15.1. Sekretari/ja i/e Asamblesë bën pjesë në Kryesi dhe ka detyrat e përcaktuara;
- 15.2. Sekretari/ja me kërkesë të kryetarit, thërret seancën, cakton datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës dhe mban procesverbalin;
- 15.3. Sekretari ruan dokumentet e Asamblesë dhe ë bën evidentimin e prezencës së asamblistëve;
- 15.4. Sekretari ka përgjegjësi të monitorojë zbatimin e planit të veprimit të Asamblesë.

#### **Neni 16**

##### **Detyrat dhe të drejtat e Kryesisë së Asamblesë**

- 16.1. Kryesia e Asamblesë zgjidhet nga vetë asamblistët dhe duhet të jetë e përbërë nga pesë(5) anëtarë;
- 16.2. Anëtar-i/ja i/e Kryesisë nuk mund të ketë më shumë se një post;
- 16.3. Mbajnë shënime dhe shfaqin idetë e tyre për të mirën e fëmijëve;
- 16.4. Cakton rendin e ditës, në bashkëpunim me anëtarët e Kryesisë, (nënkryetarët, sekretar/in /en, arkëtar/in/en, në krye me kryetarin/en);
- 16.5. Harton planprogramin dhe kalendarin e punës;
- 16.6. Vendimet e Kryesisë miratohen nga asamblistët.

#### **Neni 17**

##### **Komisionet**

- 17.1. Komisionet janë organe të përkohshme ose të përhershme, që kujdesen për zbatimin e objektivave të Asamblesë;
- 17.2. Komisionet që janë organe të përhershme:
  - a) Komisioni për bashkëpunim me organet profesionale të shkollës, këshillin e shkollës, këshillin e prindërve, mësuesit dhe komunitetin lokal;
  - b) Komisioni për sport dhe kulturë;
  - c) Komisioni për veprim humanitar;



- d) Komisioni për informim;
- e) Formimi i komisioneve sipas nevojave eventuale të Komunës;
- 17.3. Vendimi mbi themelimin, përgjegjësitë dhe shuarjen e komisioneve miratohet nga Asambleja, në interesin më të mirë të fëmijëve;
- 17.4. Secili komision ka udhëheqësin e vetë, i cili zgjidhet me votim brenda komisionit (shih Rregulloren).

### **Neni 18** **Komisionet dhe detyrat e tyre**

- 18.1. Komisionet i kryejnë të gjitha punët dhe detyrat sipas planit të veprimit;
- 18.2. Plani i veprimit të secilit komision duhet të miratohet nga Asambleja;
- 18.3. Komisionet mbajnë mbledhjen e përgjithshme me Kryesinë;
- 18.4. Shkarkimi i komisioneve bëhet nëse nuk respektojnë dhe nuk mbajnë përgjegjësi për punën e tyre.

### **Neni 19** **Procesverbali**

- 19.1. Për punimet e seancës së Asamblesë Komunale të Fëmijëve mbahet procesverbali;
- 19.2. Procesverbali i përmban të dhënat kryesore për punimet e seancës, propozimet e paraqitura dhe konkluzionet e miratuara në lidhje me çështjet e rendit të ditës;
- 19.3. Procesverbali sipas rregullit, nëpërmes postës elektronike dhe mënyrave të tjera, u shpërndahet të gjithë asamblistëve, më së voni një (1) ditë para seancës që do të miratohet;
- 19.4. Sekretari/ja i/e Asamblesë ka për detyrë përgatitjen dhe ruajtjen e procesverbaleve origjinale të seancave të Asamblesë.

### **Neni 20** **Publikimi dhe njoftimi**

- 20.1. Puna e Asamblesë është publike, ku të gjitha procesverbalet, planet e veprimit, minutat e takimeve, publikimet, dhe çfarëdo e dalë nga Asambleja, publikohen në ueb-faqen e Asamblesë (<http://akf-ks.org/>) dhe mbikëqyret nga Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete i Komunës së Prishtinës;
- 20.2. Kryesia kujdeset për informimin e rregullt të anëtarëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e Asamblesë, qoftë drejtpërdrejt, komisionit për informim ose përmes publikimit të aktiviteteteve.

### **Neni 21** **Bashkëpunimi**

- 21.1. Për të arritur qëllimet, Asambleja krijon kontakte dhe bashkëpunon me shoqata dhe organizata të tjera profesionale, shkencore, arsimore dhe të ngjashme;
- 21.2. Asambleja bashkëpunon dhe koordinohet me Komunën - Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

**Neni 22**  
**Mjetet dhe financimi**

Mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes: planifikimit buxhetor komunal dhe qeveritar (buxhetimit miqësor për fëmijë), mbledhjes së fondeve, shkollat, kontributet vullnetare të nxënësve, mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit dhe donatorë të tjerë.

**Neni 23**  
**Modifikimi i Rregullores**

Ndryshimet në Rregullore janë të mundshme, në bazë të propozimit të një të tretës (1/3) së anëtarëve të Asamblesë.

**Neni 24**  
**Pushimi i punës së Asamblesë**

Asambleja pushon së punuari me vendimin e shumicës së anëtarëve, kur pushojnë kushtet për arritjen e objektivave.

**Neni 25**  
**Dispozitat përfundimtare**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete, Drejtoria e Arsimit dhe drejtoritë e tjera komunale.

**Neni 26**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb - faqen e Komunës së Prishtinës

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-011/02-187743/19, më 01.08.2019**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

